



# PARTIA DEMOKRATIKE SHQIPTARE

---

rr. "Ilindenska", QRT, kat 1, lok.nr.5, 1200 Tetovë, Mob: +389 70 389 660

e-mail: [info@gurra-pdsh.org](mailto:info@gurra-pdsh.org), web: [www.gurra-pdsh.org](http://www.gurra-pdsh.org)

## KONGRESI IX I PDSH-së REZOLUTA

Kongresi i IX i PDSH-së, duke analizuar zhvillimet politike në vend dhe pozitën e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, vlerëson se proceset politike të viteve të fundit kanë sjellë fragmentim të përfaqësimit shqiptar dhe nënshtrim të tij ndaj interesave të faktorit maqedonas. Kongresi konsideron se pazaret politike dhe vendosja e interesave personale mbi interesin kombëtar kanë dëmtuar seriozisht subjektivitetin politik të shqiptarëve dhe kanë degraduar funksionimin demokratik të skenës politike shqiptare.

Kongresi konstaton se përmes pushtetit politik dhe ekonomik është ushtruar ndikim i drejtpërdrejtë mbi subjektet politike shqiptare, duke cenuar pavarësinë e tyre politike dhe duke dobësuar përfaqësimin autentik të shqiptarëve në institucionet shtetërore. Vlerësohet se pas vitit 2001 shqiptarët janë dëmtuar politikisht, ekonomikisht dhe institucionalisht nga qeverisja e keqe dhe sistemi klientelist i ndërtuar mbi korrupsionin, nepotizmin dhe kontrollin politik. Përgjegjësinë kryesore për këtë gjendje e mban BDI-ja dhe pasardhësit e tyre, për shkak të dobësisë së organizimit politik shqiptar, deformimit të proceseve zgjedhore dhe humbjes së besimit të qytetarëve.

Kongresi riafirmon angazhimin për një marrëveshje të re politike ndërmjet dy kombeve shqiptarëve dhe maqedonasve, kjo marrëveshje politike duhet të kalojë në kushtetutë dhe ligje të bazuar në parimin e barazisë së plotë politike, juridike dhe institucionale, ku do të inkorporohet mekanizmi i vendimmarrjes konsesuale dhe garantimit të vetos si mekanizëm që parandalon majorizimin dhe diskriminimin si garanci për stabilitetin demokratik, funksionimin e shtetit të së drejtës dhe të ardhmen evropiane të Maqedonisë së Veriut.

PDSH rithekson përkushtimin ndaj politikës kombëtare, demokratike dhe integruese, me synim rikthimin e besimit të qytetarëve dhe mbrojtjen e interesave shqiptare. Kongresi vlerëson se Partia Demokratike Shqiptare mbetet opozita e vërtetë shqiptare në vend, duke ruajtur pavarësinë politike dhe përfaqësimin autentik të shqiptarëve. Njëkohësisht, riafirmohet përkushtimi për bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare, SHBA-të, Britaninë e Madhe, BE-në, NATO, si dhe

mbështetja për forcimin e demokracisë, sundimit të ligjit dhe realizimin e barazisë së plotë ndërmjet shqiptarëve dhe maqedonasve.

Kongresi riafirmon se Partia Demokratike Shqiptare mbetet forca më e qëndrueshme, e pavarur dhe e vërtetë politike shqiptare në vend, e vendosur për të rifilluar me energji të reja betejën për dinjitetin politik të shqiptarëve.

Tetovë, 24 maj 2026

Kongresi IX i PDSH-së